



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:264585  
Datë: 21.11.2022  
Numri i dokumentit: 03668881

**C.nr.1080/21**

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË**, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Betim Behluli si dhe më Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina në çështjen juridike të paditësve F. K. dhe Z. G. - K. të punësuar në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Ibrahim Mazreku” në Malishevë i përfaqësuar nga Av. Z. H. nga Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Malishevës- Drejtoria Komunale e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim i shujtave, me datën 21.11.2022 merr këtë:

### **A k t v e n d i m**

**Konstatohet e tërhequr** padia e paditësve F. K. dhe Z. G. - K. të punësuar në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, e parashtruar kundër të paditurës Komuna e Malishevës- Drejtoria Komunale e Arsimit me të cilën ka kërkuar kompensimin në emër të shujtave.

### **A r s y e t i m**

Paditësit F. K. dhe Z. G. - K. të punësuar në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Ibrahim Mazreku” në Malishevë, përmes të autorizuarit të tyre Av. Z. H. nga Prishtina ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Malishevës- Drejtoria Komunale e Arsimit, sipas bazës juridike kompensim të shujtave.

I autorizuari e paditësve me datë 01.11.2022 me parashtrësë e njofton gjykatën se e tërheqë padinë të parashtruar pranë kësaj gjykate, duke theksuar se paditësit për periudhën e kërkesës në emër të shujtave kanë qenë në muajin e lehonisë, andaj për të mos krijuar shpenzime të pa arsyeshme tërhiqem për këtë lëndë.

Meqenëse i autorizuari i paditësve përmes parashtrësës e ka tërhequr padinë, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi konform nenit 261, par.1 dhe 3 të LPK-së.

**Gjykata Themelore Gjakovë-Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm.  
C.nr.1080/21 me dt. 21.11.2022**

**Gjyqtari  
Betim Behluli**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij Aktvendimi në kuptim të nenit 261 par.4 të LPK-së nuk lejohet e drejta në ankesë.